# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446222**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama vijon me dy standarde/ Merr në mbrojtje Veliajn |
| ADRESA | `https://www.cna.al/politike/rama-vijon-me-dy-standarde-merr-ne-mbrojtje-veliajn-i474236` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 13:39:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 13:32:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `922511691ac4462dad124d97bfc3699b21bb5dd66cc781166db3ec0da804a4ef` |
| TEKSTI | `85e2ae220c30db09d8af2ed08e2330f93d5dc591462b62545755fdaa12c138ec` |
| PAMJA | `664abdfa92b79cbcbcff397249ab15c48d7194819e6922206a4aae579d454a2b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `847cdfdd8057c0f7ef15b1a067d3e46f2a2607538e41372cbda2aaa9fe610bc3` |
| E MËPARSHMJA | `0774ed722e3ac669a8be2f5c1da7ba940335e40ac13494070c104282fd8c24c0` |
| RRËNJA MERKLE | `20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/847cdfdd8057c0f7ef15b1a067d3e46f2a2607538e41372cbda2aaa9fe610bc3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

### E fundit!

x

16:37 Aktualitet

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi ka...

# Rama vijon me dy standarde/ Merr në mbrojtje Veliajn

15 Shtator 2026, 15:32, Politikë CNA



Kryeministri Edi Rama ka bërë një reagim në rrjetet sociale në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë për kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj.

Reagim në të cilin Rama ka vijuar qëndrimin e tij me dy standarde në lidhje me këtë çështje.

- 

## Dy standardet e Ramës me Erion Veliajn/ Redaktori në hall

Fillimisht rreth një vit më parë, kryeministri kërkoi shkarkimin e Veliajt, ndërsa tani shprehet se Tirana ka mbetur pa kokë dhe Veliaj mbahet në qeli pa gjyq.

Ndërkohë që të gjitha shkallët e gjyqësorit kanë vendosur qëndrimin në qeli të Erion Veliajt, i akuzuar për 5 vepra të rënda penale.

Kryeministri shprehet se kryeqyteti prej rreth dy vitesh jeton me kokë të prerë. Në fakt, është vetë Veliaj që vijon ta lërë në këtë gjendje Tiranën dhe ta mbajë peng, pasi nuk pranon të japë dorëheqjen nga posti i kryetarit dhe kërkon ta mbajë të lidhur pas vetes karrigen e kryebashkiakut për ta përdorur në favor të interesave të tij personale.

Po ashtu Rama në reagimin e bërë shprehet se rasti i Veliajt është një kalvar unik në historinë e Europës. Në fakt, kryeministri duhet ta dijë se ai që e ka kthyer këtë proces gjyqësor në kalvar është vetë Erion Veliaj.

Është Veliaj ai që prej 14 muajsh nuk shkon në gjykatë të përballet me 13 akuzat që rëndojnë ndaj tij.

**Reagimi i Ramës**

*Përsëri Tirana pa kokë dhe përsëri kryetari i zgjedhur e i pagëzuar rishtaz nga vetë Kushtetuesja si i vetmi në detyrë dhe i palëvizshëm nga detyra, nuk mund të lëvizë nga qelia ku mbahet pa gjyq!*

*Po, rregulli e do që vendimet e gjykatave të respektohen dhe unë i nështrohem gjithnjë këtij rregulli - madje as nuk i komentoj vendimet përpara formës së prerë.*

*Por, përtej faktit që kalvari i Erion Veliajt është unikal në historinë e Europës demokratike dhe gjithashtu faktit që ende nuk shihet gjëkundi prova e rrezikshmërisë ekstreme, e cila mund të arsyetojë kyçjen e pambarimtë në qeli të një të zgjedhuri nga populli, ka një të vërtetë tjetër të hidhur:*

*Askush s'po do t'ia dijë për koston përditë e më të lartë të të parit kryeqytet në botë, që prej thuajse dy vjetësh jeton me kokë të prerë dhe për haraçin që thuajse 1 milionë banorë duhet t'i paguajnë përditë këtij eksperimenti të paparë e të padëgjuar juridik, social dhe ekonomik.*

Përsëri Tirana pa kokë dhe përsëri kryetari i zgjedhur e i pagëzuar rishtaz nga vetë Kushtetuesja si i vetmi në detyrë dhe i palëvizshëm nga detyra, nuk mund të lëvizë nga qelia ku mbahet pa gjyq!

Po, rregulli e do që vendimet e gjykatave të respektohen dhe unë i nështrohem…

— Edi Rama (@ediramaal) September 15, 2026









Të sugjeruara

5 viktima nga energjia elektrike/ Injorimi i ngjarjeve tregon fytyrën e vërtetë të Ramës

Rama, letër urimi Kurtit për mandatin e ri qeverisës/ E fton për vizitë në Shqipëri

Korreshi: Sadush barsoleta, me shall të kuq si partizan sa herë ka mbledhje

Çmimi i naftës në Shqipëri/ PD, akuza Ramës: Shton barrën fiskale për shqiptarët

Rama në Napoli/ Viziton Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit "L'Orientale"

Projektligji që "blen" Kushtetuesen/ PD bën kërkesë për seancë dëgjimore publike

Ndryshime në Bashkinë Shkodër, 2 nënkryetarë të rinj

Inaugurimi i Konsullatës së Nderit të Shqipërisë në Napoli/ Rama merr pjesë në ceremoni

Pagat e magjistratëve/ Rama: Askush nuk e urdhëron legjislativin se kur duhet ta ngrejë dorën

Efektivi dhunoi protestuesin/ Këlliçi: Polic patronazhist ordiner

Çështja "KAYO" dhe akuzat për trafik armësh/ Opozita ngre pikëpyetje

"Blerja" e Gjykatës Kushtetuese/ 2 deputetët tregojnë planin e mazhorancës

"Sa u shkon paga?"/ Braçe me laps e letër për gjyqtarët, përplaset me socialistët

Trafiku i armëve/ Berisha: Yeffet një Agasi i huaj, ndrikulla Puca prodhon autoblinda

Berisha tregon detaje nga vizita në SHBA

Balliu: Kayo nën hetim parlamentar, pyetjet për Ron Yeffet dhe rrethin e Ramës kërkojnë përgjigje

Deputeti i PD-së: Të gjithë ministrat e Ramës janë thjesht kukulla

Berisha: Rreth 6 mijë nxënës më pak brenda vitit, alarm i madh demografik dhe arsimor

"Territorialja" në Elbasan/ Rama zbulon çfarë ndodh me Cërrikun, Belshin, Librazhdin dhe Prrenjasin

Ish-deputeti: Ngritja e Muzeut Hebraik në Vlorë po u bën nder shqiptarëve

editorial

13:52 Editorial Elvi FUNDO

Erion Veliaj nuk i lë prokurorisë asnjë mundësi për ta harruar

CNA LIVESTREAM




pafajësinë e ish-krerëve të Kosovës

ndryshe

Shtëpia e Anne Frank është një nga vendet më të vizituara të Amsterdamit

KURSI I KËMBIMIT

1 CHF = 97.24 Lek

Na ndiqni edhe në

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.